



UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË  
Fakulteti Ekonomik

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË  
REKTORATI

Pranuar me dt. 24.11.2023			
Nësia orga	Num	Nr.Ekzem	Vlera
	2668/1		

Nr. Prot. 322 Dt. 23.11.2023

Në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 9, paragrafi 4 të Rregullores nr. 1670 dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, Këshilli i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen mbajtur më 23.11.2023, pas shqyrtimit morri

Vendim

1. Refuzohet Raporti i Komisionit të ankesave Nr. prot. 319 dt. 20.11.2023, me të cilin është propozuar miratimi i ankesës të ushtruar nga kandidatja, Msc. Ardita Ibishi (Phd candidate), e pakënaqur me vendimin e Këshillit të Fakultetit nr. 314/1 dt. 03.11.2023, në procesin e angazhimit të një bashkëpunëtori të jashtëm për pozitën: **Një asistent për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II**, (konkurs i përbashkët për Fakultetin e Gjeoshkencave; Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore; Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Edukimit) – konkursi i datës 10.10.2023.
2. Mbetet në fuqi vendimi propozues i Këshillit të Fakultetit nr. 314/1 dt. 03.11.2023, për aprovimin e Raportit të Komisionit vlerësues i dhënë nga dy anëtarë të Komisionit vlerësues – **mendim i ndarë** dhe propozimi i dhënë në raport që në këtë pozitë të angazhohet Msc. Erëza Rushiti (Phd candidate).
3. Këshilli i Fakultetit propozon që kandidat-i/ja Msc. Erëza Rushiti (Phd candidate) të angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm – asistent për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët **Gjuhë angleze I dhe II**.
4. Pjesë e këtij vendimi janë: Raporti i Komisionit të ankesave; ankesa e parashtruar nga kandidatja Msc. Ardita Ibishi (Phd candidate); vendimi i Këshillit të Fakultetit nr. 314/1 dt. 03.11.2023.

Arsyetim

Në konkursin e përbashkët për katër fakultete (për Fakultetin e Gjeoshkencave; Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore; Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Edukimit), për angazhimin e një bashkëpunëtori të jashtëm për pozitën: **Një asistent për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II**, kanë

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; [info@umib.net](mailto:info@umib.net); Tel: +383-28/515516 – lokali 6



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**  
**Fakulteti Ekonomik**

aplikuar dy kandidatë-e. Anëtarët e komisionit vlerësues, në dy raporte të ndara kanë konstatuar se dy kandidatet i plotësojnë kushtet e konkursit, mirëpo lidhur me propozimin për angazhim kanë dhënë mendime të ndryshme. Me rastin e shqyrtimit të raporteve të komisionit vlerësueses Këshilli i Fakultetit, në mbledhjen e mbajtur më 02.11.2023 ka vendosur që të miratoj raportin e komisionit vlerësues të paraqitur nga dy anëtarë të komisionit vlerësues me propozim që kandidatja Msc. Erëza Rushiti (Phd candidate), të angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm – asistent për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët **Gjuhë angleze I dhe II**.

Në vendimin e Këshillit të Fakultetit lidhur me angazhimin e Msc. Erëza Rushiti (Phd candidate), në afatin e paraparë me rregullore, ankesë ka ushtruar kandidatja e pakënaqur me vendimin e KF Msc. Ardita Ibishi (Phd candidate). Komisioni i ankesave pas shqyrtimit të ankesës ka hartuar raport duke konstatuar se dy kandidatet i plotësojnë kushtet e konkursit mirëpo kandidatja Msc. Ardita Ibishi (Phd candidate) i plotëson më së miri kushtet e konkursit, për shkak të përvojës më të gjatë në pozitën e kërkuar në konkurs si dhe të një punimi që kandidatja Msc. Ardita Ibishi (Phd candidate) e ka si autore e parë, të indeksuar në platformën SCOPUS, gjithashtu si përparësi ka konstatuar edhe gadishmërinë e parashtruesës të ankesës, që gjatë punës së sajë në UIBM, të bashkëpunoj me kolegët dhe studentët.

Këshilli i Fakultetit konstaton, se komisioni i ankesave gjatë shqyrtimit të ankesës dhe hartimit të raportit ka tejkalluar kompetencat në rastin kur e ka paraqitur si përparësi të parashtrueses të ankesës performancën e mirë për gadishmërinë që të bashkëpunoj me kolegët dhe studentët, pa parashtruar ndonjë provë për këtë dhe duke mos qenë kjo performancë si përparësi në kuadër të kushteve të konkursit për pozitën. Sa i përket përparësisë të dhënë nga komisioni i ankesave lidhur me përvojën më të gjatë në pozitën e kërkuar me konkurs, Këshilli i Fakultetit konstaton se përvoja më e gjatë mund të merrej si përparësi nëse kandidatët nuk do të plotësonin të gjitha kushtet e konkursit të parapara me paragrafin 3 të nenit 7 të Rregullores nr. 1670 dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM. Në këtë rast kandidatët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe nuk mund të merret si përparësi (shih neni 7 paragrafi 5). Sa i përket përparësisë të dhënë nga komisioni i ankesave lidhur me punimin që kandidatja Msc. Ardita Ibishi (Phd candidate) e ka si autore e parë, të indeksuar në platformën



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**"ISA BOLETINI"**  
**MITROVICË**  
**Fakulteti Ekonomik**

SCOPUS, Këshilli i Fakultetit konstaton se ky kriter nuk kërkohet me rregulloren përkatëse për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve.

Pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit të ankesave, Këshilli i Fakultetit ka vendosur që të mbetet në fuqi vendimi propozues i Këshillit të Fakultetit nr. 314/1 dt. 03.11.2023, për aprovimin e Raportit të Komisionit vlerësues i dhënë nga dy anëtarë të Komisionit vlerësues – **mendim i ndarë** dhe propozimi i dhënë në raport që në këtë pozitë të angazhohet Msc. Erëza Rushiti (Phd candidate). Gjatë vendosjes Këshilli i Fakultetit ka marr parasysh përparësitë e paraqitura në raport, nga Komisioni vlerësues i dhënë nga dy anëtarë të Komisionit vlerësues – **mendim i ndarë**, respektivisht performancës më të lartë në studime nga kandidatja Msc. Erëza Rushiti (Phd candidate).

Këshilli i Fakultetit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Senatit;
- Zyrës për çështje akademike;
- Menaxhmentit të fakultetit;
- Arkivit.



Prof. asoc. dr. Qazim Tmava

Dekan



UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" NË MITROVICË  
FAKULTETI EKONOMIK

Nr. prot. 319 Dt. 20.11.2023

Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga Fakulteti Ekonomik për konkursin e shpallur të datës 10.10.2023 nga Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë për poziten: **Një asistent për lëndët Gjuhë angleze I dhe II**, pasi shqyrtoi ankesën me numër protokoli 318, të datës 14.11.2023 të kandidatës Ardita Ibishi, bazuar në Statutin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, në Rregulloren për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin Isa Boletini në Mitrovicë me numër protokoli 1670 të datës 28.09.2021 paraqet këtë:

**R A P O R T**

Të dyja kandidatet, Ardita Ibishi dhe Erëza Rushiti i plotësojnë kushtet e parapara në konkurs (Rregullorja me nr.1670, neni 7, pika 3; 3.1, 3.2, 3.3).

Sipas dokumentacionit të dërguar në adresën tonë, Ardita Ibishi ka raport pozitiv nga kryetarja e komisionit recensues (Raporti i komisionit vlerësues me nr.299, data 30.10.2023). Kurse, dy anëtarët e tjerë kanë hartuar raport tjetër për kandidaten, Erëza Rushiti (Raporti i komisionit vlerësues me nr.299/1, data 30.10.2023) dhe me këtë rast Këshilli i Fakultetit ka votuar pro këtij raporti.

**Përfundim:** Komisioni për shqyrtimin e ankesave konstatoi se kandidatja Ardita Ibishi, për shkak të përvojës paraprake në UIBM nga 2018 -2022 si dhe në UP, në Fakultetin Arkitekturës dhe Ndërtimtarisë nga 2019 ka përparësi ndaj kandidatës Erëza Rushiti për shkak të përvojës më të gjatë në poziten e kërkuar në konkurs. Ardita Ibishi gjatë punës së saj në UIBM ka treguar performancë të mirë dhe ka qenë e gatshme të bashkëpunojë me kolegët dhe studentët. Ajo ka gjithashtu një punim si autore e parë të indeksuar në platformën Scopus si dhe të gjitha nivelet e studimit të saj i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës. Prandaj, si komision ne ndajmë të njejtin mendim se Ardita Ibishi i plotëson më së miri kushtet e parapara në konkurs.

Mitrovicë, 20.11.2023

**Komisioni për shqyrtimin e ankesave:**

Prof. Ass. Dr. Mirsade Osmani, kryetare

Prof. Dr. Zarife Bajraktari-Gashi, anëtare

Ass. Arif Krasniqi, anëtar